VENDIM
Nr.440, datë 9.6.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT "NEW GENERATION" (BREZI I RI), TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në kolegjin profesional privat "New Generation" (Brezi i Ri), Tiranë, të programeve të studimit jouniversitare, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

a) Parukeri të avancuar;

b) Estetikë të avancuar.

2. Këto programe studimi jouniversitare, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diplomë në:

a) Parukeri të avancuar;

b) Estetikë të avancuar.

3. Kolegji profesional privat "New Generation" (Brezi i Ri), Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, vetëm pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha